



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

KABINETI

Bulevardi "Bajram Curri" Tirana, Albania - Tel/Faks. +355 4 36462937 - www.moh.gov.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2011

Lënda : Realizimi i treguesve të monitorimit financiar për Ministrinë e Shëndetësisë per 6 mujorin e pare te vitit 2011.

Drejtuar : **MINISTRISË SË FINANCAVE**

DREJTORISË SË PËRGJTHSHME TË BUXHETIT

Në zbatim të Ligjit Nr. 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr.10355 date 2.12.2010 "Per buxhetin e vitit 2011", ne zbatim te Udhezimit Nr. 4 date 27.1.2011 "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011" bashkëlidhur ju dërgojmë informacionin për realizimin e buxhetit të gjashtemujorit te pare te vitit 2011.

Duke ju falenderuar,

SEKRETARE E PERGJITHSHME

MIRELA CANO

Raporti i monitorimit per Ministrine e Shendetesise per gjashtemujorin e pare te vitit 2011

Ministria e Shendetesise , per vitin 2011, administron dhe menaxhon fondet publike sipas kater programeve te miratuara, si vijon:

1. Planifikim menaxhim administrim
2. Sherbime te kujdesit shendetesor paresor
3. Sherbime te kujdesit shendetesor dytesor
4. Sherbime te shendetit publik

Realizimi i shpenzimeve te buxhetit per gjashtemujorin e pare te vitit 2011, paraqitet si me poshte vijon:

Titulli	Emri i Programit	Buxheti 2011 ne mije leke	Fakti 2011 ne mije leke	% e realizimit 2011	Struktura ne % fakti 3 mujori 2011
O11	Planifikim Menaxhim Administrim	292.300	162.958	55.7%	1.1%
O52	Sherbime te Kujdesit Shendetesor Paresor	8.914.179	3.873.239	43.4%	27.5%
O53	Sherbime te Kujdesit Shendetesor Dytesor	17.632.186	8.971.220	50.8%	63.2%
O55	Sherbime te Shendetit Publik	2.785.100	1.167.148	42%	8.2%
Totali i shpenzimeve te ministrise		29,623.765	14.174.565	47.8%	100

Struktura e shpenzimeve sipas programeve paraqitet si me poshte vijon:

Ne
perqindje

Titulli	Emri i Programit	PBA Plan 2011	Budget 2011	Fakti 2011
O11	Planifikim Menaxhim Administrim	1.0	1	1.1
O52	Sherbime te Kujdesit Shendetesor Paresor	30.1	27.3	27.5

O53	Sherbime te Kujdesit Shendetesor Dytesor	59.5	63.5	63.2
O55	Sherbime te Shendetit Publik	9.4	8.2	8.2
Totali		100.0	100.0	100.0

Rreth 1% te totalit te shpenzimeve faktike eshte perdorur per programin planifikim menaxhim administrim. Per programin sherbime te kujdesit shendetesor paresor eshte perdorur 46,6%. Per programin sherbime te kujdesit shendetesor dytesor eshte perdorur po ashtu rreth 46,6%, ndersa per programin sherbime te shendetit publik eshte perdorur rreth 5,8% te totalit te fondeve te perdorura.

Me poshte po paraqesim nje analize te detajuar te treguesve te monitorimit te buxhetit sipas programeve buxhetore.

1. Programi Planifikim Menaxhim Administrim

Objektivat kryesore te ketij programi jane:

- Zbatimi i planit afat shkurter te perafimit te legjislacionit
- Plotesimi i kushteve te punes ne nivel qendror (MSH) dhe institucioneve te tjera te ketij programi.
- 1% e stafit te profesionisteve te shendetit te trajnuar nga qendra e formimit te vazhdueshem profesional
- Hartimi i strategjse per shtrirjen e praktikes se vleresimit te performances se spitaleve me ane te treguesve perkates

Realizimi i shpenzimeve te gjashtemujorit te pare per kete program perben 1.1% te totalit te shpenzimeve te kesaj ministrie . Krahasuar me planin vjetor sipas zerave kryesore rezulton si me poshte:

Shpenzime korente 81.4%

Shpenzime kapitale 18.6%

Ne kete program jane parshikuar te realizohen produktet e meposhteme, ecuria e te cilave krahasuar me planin paraqitet si vijon:

Ne mije leke

	Buxheti	Fakti	Statusi I realizimit
Emri I Produktit	2011	2011	3M I
Menaxhimi i pol. sektoriale	246.100	132.648	Plotesisht

Bl. Paj mobil zyre kompjuterike	5.390	1.078	Pjeserisht
Proj te mbesht me det dog e kl	3.850	1.192	Plotesisht
Ndertim e rikonst ambjentesh aparati	30,760	28.040	Plotesisht

Fondi prej 5390 mije leke i cili eshte parashikuar per “Blerje pajisje mobilimi zyre e kompjuterike”, u cel ne fillim te vitit me emertimin “fond i ngrire”.Ne muajin maj te ketij viti u arrit shkrijra e tij por procedura e prokurimit kryhet nga ana e Ministrise se Brendshme, procedure qe eshte ende ne proces.

2.Programi sherbime te kujdesit shendetesor paresor

Objektivat kryesore te ketij programi jane:

- Permiresim i ofrimit te sherbimit paresor nepermjet zgjerimit te skemes se medikamenteve nga 409 qe ishin ne 2010, ne 420 barna ne vitin 2011
- Zvogelim i vdekshmerise foshnjore ne vitin 2011 me 0.5 per 1000 krahasuar me vitin 2010
- Zvogelim i vdekshmerise amtare me 1/100000 ne vitin 2011 krahasuar me 17 per 100000 qe eshte ne vitin 2008
- Rritja e vizitave/kontakteve te pacientit ne kujdesin paresor ne 8.6 vizita/dite/mjek ne vitin 2011 nga 8.4 ne vitin 2010
- Plotesim ne masen 58% te standarteve te infrastruktures krahasuar me 50% qe realizohen ne 2011
- 9% e popullsisë e mbuluar me shërbim parandalues çdo vit

Realizimi i shpenzimeve te tremujorit te pare per kete program perben 27.5% te totalit te shpenzimeve ke kesaj ministrie . Krahasuar me planin vjetor sipas zerave kryesore rezulton si me poshte:

Shpenzime korente	93.2%
Shpenzime kapitale	6.8%

Ne kete program jane parashikuar te realizohen produktet e meposhteme, ecuria e te cilave krahasuar me planin paraqitet si vijon:

	Buxheti	Fakti	Statusi I realizimit
Emri I Produktit	2011	2011	3M I

Sigurimi I mbulimit me barna per popullsine aktive dhe jo aktive	6.200.000	2.832.000	Plotesisht
Mbulimi I KSHP	822.000	411.000	Plotesisht
Rikonstruksione te qsh dhe ambulancave (p vendor)	50.000	0	Aspak
Ndert.te reja te qsh dhe ambulancave (p vendor)	50.000	0	Aspak
Bl. Pajisje mobilimi per qsh	8.000	0	Aspak
Bl.pajisje mjeksore grupi I	44.420	0	Aspak
Bl. Pajisje laboratorike klinike per qsh dhe polikl e Tiranës	19.266		Aspak
Funksionimi I Kl Qeveritare	21.800	9.528	Plotesisht
Funksionimi I KSU	45.500	15.558	Plotesisht
Staf mjeksor I trajnuar	2.000	0	Aspak
Projekti I koperacionit italian per ndertimin e dy poliklinikave (TVSH)	98.385	0	Aspak
Blerje pajisje mjeksore Gr2 (koperacioni italian)	211.599	0	Aspak
Projekti modernizimit te sistemit shendetesor BB	450.103	190.831	Plotesisht
Fuqizimi I pergjigjes kombetare ndaj HIV AIDS	90.431	40.060	Plotesisht
Pershkallezimi I pergjigjes kombetare ndaj TBC	16.545	4.369	Plotesisht
Trajtimi I pac ne spit e duresit	670.000	344.000	Plotesisht
Ndertime e rikonstruksione per godinat e KSHP	85.564	16.187	Pjeserisht
Pajisje mobilimi, teknologjike, elektrike per godinat e KSHP	10.066	1.515	Aspak
Ndertimi I qsh dhe ambulancave nga Gjysem Hena e Kuqe	18,000	1.953	Pjeserisht

Per sa i perket “Rikonstruksione te qendrave shendetesore dhe ambulancave (pushteti vendor) dhe Ndert.te reja te qendrave shendetesore dhe ambulancave (pushteti vendor)” paraqiten me mosrealizim per arsye se vendimi i ndarjes se fondit sipas njesive te qeverisjes vendore u miratua me 11.3.2011, por celja nga ana e Ministrise se Financave ende nuk eshte bere, qe Ministria e Shendetesise t’I akordoje fondet sipas objekteve bashkive dhe komunave.

Per Projekti i koperacionit italian per ndertimin e dy poliklinikave (TVSH) dhe Blerje pajisje mjeksore Gr2 (koperacioni italian) jemi ne pritje te miratimit nga ana e Ministrise se Punesve te Jashteme ne Itali per fillimin e procedurave.

Per Projektin modernizimit te sistemit shendetesor (Banka Boterore) aktualisht eshte disbursuar Leter kredia per blerjen e pajisjeve mjeksore ne vleren 1,179. 000 USD si dhe ka perfunduar instalimi i pajisjeve.

Per “Ndertime e rikonstruksione per godinat e Kujdesit shendetesor paresor” pavaresisht vleres se vogel te financimit te realizuar, vlera e prokuruar deri ne periudhen per te cilen flasim kap vleren e 77milion lekeve ose rreth 90% kundrejt fondit limit.Jane lidhur kontratat per ato objekte qe jane prokuruar dhe financimi do te kryhet pas dorezimit te situacioneve pjesore ose total. Po I njeti arsyetim vlen dhe per “Pajisje mobilimi, teknologjike, elektrike per godinat e kujdesit shendetesor paresor”, per te cilat aktualisht kane filluar procedurat e tenderimit, dhe fondi I deritanishem I prokuruar(per 6-mujorin) eshte 10.600.414 leke.

3. Programi Sherbime te kujdesit shendetesor dytesor

Objektivat kryesore te ketij programi jane:

- Mbulim 82% i nevojës për shërbim spitalor në vitin 2011 krahasuar me 80% që janë plotësuar në 2010
- Plotësim 77% i nevojave të spitaleve rajonale me pajisjet e domosdoshme mjeksore në shërbimet baze(patologji,kirurgji,pediatri), në vitin 2011, referuar 70% që plotësohen 2010
- Plotësim në masën 40% i nevojave për pajisje që trajtojnë mbetejet spitalore në spitalet rajonale nga 20% që është aktualisht.
- Plotësim në masën 100% i nevojave baze të urgjencave të spitaleve rajonale dhe urgjencës pediatrike të Tiranës krahasuar me 50% të plotësuar në vitin 2010
- Plotësim 100% i nevojave të imazherisë diagnostikuese në 6 spitale rajonale dhe në QSUT , krahasuar me 40% që ishte në vitin 2010
- Plotësimi i nevojave me pajisje mjeksore në Shërbimin e Neurokirurgjisë në Spitalin Nënë Tereza në masën 100% nga 45% që ka qenë në vitin 2010.
- Plotësimi në masën 35% krahasuar me 30% që është aktualisht, të sistemeve të informacionit klinik dhe financiar, si dhe krijimit të një sistemi monitorimi për matjen e performancës së spitaleve.

Realizimi i shpenzimeve të tremujorit të parë për këtë program përben 63.2% të totalit të shpenzimeve të kësaj ministrie . Krahasuar me planin vjetor sipas zerave kryesore rezultojnë si më poshtë:

Shpenzime korente 76%

Shpenzime kapitale 24%

Ne kete program jane parshikuar te realizohen produktet e meposhteme, ecuria e te cilave krahasuar me planin paraqitet si vijon:

Emri I Produktit	Buxheti 2011	Fakti 2011	Statusi I realizimit
Trajtimi i pacienteve te shtruar ne spitale	13.045.000	6.413.000	Plotesisht
Mbulimi financiar i sherbimeve ne spitalet psikiatrike	425.280	226.488	Plotesisht
Funksionimi i instituc. Kombetare	737.720	160.899	Plotesisht
Projekte te mbeshtetura me kosto lokale	14.000	13.132	Plotesisht
Blerje pajisje te medha dhe komplekse faza 3 sp Shk	165.600	0	Aspak
Studim fizibiliteti faza 2 qsut	10.739	0	Aspak
Blerje pajisje mjeksore komplekse per spitalet rajonale kredia austriake	321.400	191.784	Pjeserisht
Blerje pajisje specifike per neurokirurgjine	267.400	411.269	Plotesisht
Blerje pajisje mjeksore per onkologjine	100.000		Aspak
Blerje pajisje mjeksore per Spitalin Kavaje	27.000	13.645	Plotesisht
Blerje pajisje mjeksore per sherbimin e urgjences	800.000	631.234	Plotesisht
Blerje pajisje te tjera mjeksore	75.766	8.387	Pjeserisht
Blerje pajisje mjeksore per susm	200.000	195133	Plotesisht
Blerje pajisje mobilimi, kompjuterike, elektrike , teknologjike, mobilimi	103.888	30.672	Pjeserisht
Rehabilitimi I Sp.Shkoder - kredi F3	566.830	270.006	Pjeserisht
Permireshimi I qendres se djegieve plastike ne QSUT	60.621	0	Aspak
Ndert e rikonst te ambjenteve	692.794	397.141	Pjeserisht

Per “Blerje pajisje te medha dhe komplekse faza 3 spitali Shkoder”, jemi ne fazen kur lista e pajisjeve eshte gati, kjo do te shoqerohet me dokumentacionin perkates per tu publikuar. Procedura e prokurimit eshte ende ne proces

Per “Blerje pajisje mjeksore komplekse per spitalet rajonale kredia austriake” jemi ne fazen e pergatitjes se ambjenteve ku do te instalohen pajisjet. Jemi ne pritje te alokimit ten je fondi prej rreth 50milion lekesh qe do te sherbeje per realizimin e investimeve qe kane te bejne me venien ne dispozicion te ketyre ambienteve. Ne momentin e perfundimit te punimeve per rikonstruksionin e ambienteve, firma furnizuese fillon me instalimin e scanerave dhe te rezonancave.

Per “Blerje pajisje mjeksore per onkologjine”, jemi ne fazat e negociatave me palen austriake per shumen e kredise qe do te mundesoje kete blerje

Per “Blerje pajisje mjeksore per sherbimin e urgjences” pajisjet kane ardhur dhe jane ne perfundim te procesit te instalimit.

Per “Permiresimi i qendres se djegieve plastike ne QSUT”, aktualisht QSUT ka nenshkruar kontraten respective me nje firme ndertimi. Objekti pritet te perfundoje ne fund te vitit.

Per projektin “Blerje pajisje mjekesore per neurokirurgjine” (finansim nepermjet kredise austriake), plani parashikohej te ishte 267.400 mije leke , ndersa aktualisht eshte disbursuar 411.269 mije leke.

4. Programi sherbime te shendetit publik

Objektivat kryesore te ketij programi jane:

- Permiresimi i cilesise dhe sigurise se programit te imunizimit permes zevendesimit te vaksines se poliomielitit oral me vaksine poliomieliti injektabel ne forme te kombinuar me antigene te tjere
- Reduktimi i numrit te shperthimeve epidemike me burim ndotjen e ujit ne jo me shume se 3 ne vit ne vitin 2012, krahasuar me mesatarisht 4 ne periudhen 2005-2009

Realizimi i shpenzimeve te tremujorit te pare per kete program perben 8.2% te totalit te shpenzimeve ke kesaj ministrie . Krahasuar me planin vjetor sipas zerave kryesore rezulton si me poshte:

Ne mije leke

	Buxheti	Fakti	Statusi I realizimit
Emri I Produktit	2011	2011	3 mujori
Blerja e montorimi i vaksinave	275.000	166.061	Plotesisht

Monitorimi i agjenteve mjedisore per ujrata , mjedisin, ushqyerjen, shendetin ne pune, duke respektuar standartet e BE-se.	2.400.100	969.759	Plotesisht
Ndert. e rikonst te ambienteve	43.955	28.662	Pjeserisht
Bl. Pajisje te reja per laboratoret e shendetit publik	49.161	0	Aspak
Blerje pajisje kompjuterike , elektrike , teknologjike	16.884	2.666	Pjeserisht

Per “Blerjen e monitorimin e vaksinave” vaksinat kane ardhur dhe jemi ne proces likuidimi te dergeses se fundit.

Per “Blerje pajisje kompjuterike , elektrike” jane ne proces prokurimi te perqendruar nga Ministria e Brendeshme.

Per sa i perket “Blerjes se pajisje te reja per laboratoret e shendetit publik” fondi ne total per 6-mujorin, i shperndare ne institucione eshte 49.161.000 leke. Pamvaresisht se fakti I 6-mujorit eshte zero, sqarojme se jane prokuruar rreth 76% e tyre ne vleren 37.287.000 leke. Per disa objekte te tjera jemi ende ne faze te vleresimit te ofertave.

Per “Ndertime e rikonstruksione te ambienteve” pamvaresisht se statusi I realizimit per 6-mujorin eshte “pjeserisht”, prokurimi I ketyre objekteve deri tani eshte ne masen 74%. Procedurat per objektet e tjera jane ne process.